



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARË E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

**THIRRJE**

**PËR “SHPREHJE INTERESI PËR EKSPERTË TË KOMISIONEVE TË VLERËSIMIT  
TEKNIK TË PROJEKTEVE PËR VITIN 2022 NË AGJENCINË KOMBËTARE TË  
KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT (AKKSHI)”**

Në zbatim të ligjit Nr. 80, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit Nr.607, datë 31.08.2016, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) dhe të Vendimit Nr. 567, datë 23.10.1995, të Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike”, AKKSHI shpall thirrjen për aplikim për ekspertë të Komisioneve të Vlerësimit të projekteve sipas fushave të mëposhtme: -

- Biodiversiteti dhe Mjedisi
- Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia
- Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit
- Shëndetësia dhe Shkencat Mjekësore
- Shkencat Sociale dhe Albanologjike
- Uji dhe Energjia

**Kriteret për aplikim**

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë të paktën gradën shkencore “Doktor” në fushën përkatëse apo të ngjashme me të.
2. Të kenë përvojë në kërkim shkencor dhe projekte të kërkimit shkencor.
3. Zotërimi i titujve akademikë përbën përparësi.
4. Të mos jenë në pozicione drejtuese në institucionet përkatëse.
5. Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.

## Dokumentacioni për aplikim

Aplikantët duhet të dorëzojnë në AKKSHI dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Shprehjen e interesit lidhur me motivimin dhe ekspertizën që ofron si kërkues shkencor, pjesëmarrës në projekte apo dhe vlerësues projektsh.
2. Curriculum Vitae në shqip (formati Europass).
3. Kopje të diplomës së gradës shkencore/titullit akademik që zotëron.
4. Kopje të kartës së identitetit.
5. Vetëdeklarim që aplikanti nuk është pjesë e organeve drejtuese në institucionin përkatës.

## Adresa ku do të dërgohet aplikimi

Aplikantët duhet ta dorëzojnë dokumentacionin përmes postës zyrtare pranë zyrave të AKKSHI në adresën: Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë.

Ose

Kopje e printuar, firmosur dhe skanuar (format pdf), dërguar në adresen elektronike të AKKSHI-së: [info@nasri.gov.al](mailto:info@nasri.gov.al)

## Afati i aplikimit

Afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit është **data 28.02.2022.**

## Informacion shtesë

Aplikantët e shpallur fitues si Ekspertë të Komisioneve të Vlerësimit nuk mund të jenë pjesë e grupeve të projekteve të kërkimit që vlerësohen në AKKSHI.

Ekspertët e Komisioneve të Vlerësimit të AKKSHI paguhen sipas dispozitave të Vendimit Nr. 567, datë 23.10.1995, "Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike".

Komisionet e Vlerësimit do të përbëhen nga 5 anëtarë, nga të cilët 1 prej anëtarëve do të jetë kryetar i komisionit.

Një prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të çdo fushe, do të jetë një përfaqësues i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i/e cili/a nuk do të nënshtrohet procesit të aplikimit por do të nominohet nga Akademia.